


# Tregtia me pakicë\*

## Tremujori I 2020

**Tiranë, më 18 Qershor:** Në tremujorin e parë 2020, indeksi i volumit të shitjeve në tregtinë me pakicë shënoi 99,9. Shitet në volum në tregtinë me pakicë janë ulur 0,4 %, kahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019. Kahasuar me tremujorin paraardhës, ky tregues i përshtatur sezonalisht ka pësuar rënie 4,3 %, ndikuar kryesisht nga muaji Mars.

Fig. 1 Indeksi i volumit të shitjeve në tregtinë me pakicë, (papërshtatur sezonalisht)



### Ndryshimi vjetor në indeksin e volumit të shitjeve në tregtinë me pakicë

Në tregtinë me pakicë, pa përfshirë këtu tregtinë me pakicë të hidrokarbureve, volumi i shitjeve në tremujorin e parë 2020 ka pësuar rritje prej 1,8 %, kundrejt tremujorit të parë të vitit 2019.

Në grupin “Ushqime, pije, duhan në njësi tregtare jo të specializuara dhe të specializuara”, volumi i shitjeve është rritur 5,0 %, kahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2019.

Volumi i shitjeve, për grupin “Artikuj jo-ushqimorë në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara”, është ulur 0,2 %, kundrejt të njëjtës periudhë të vitit paraardhës.

Në grupin “Tregti hidrokarbure në njësi tregtare të specializuara”, volumi i shitjeve ka pësuar rënie me 6,1 %, kahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2019.


**Për publikim 18/06/2020**

### Ndikimi i grupeve në tregtinë me pakicë

Në ndryshimin vjetor prej -0,4 %, në tremujorin e parë 2020 ndaj tremujorit të parë 2019, në tregtinë me pakicë, grupet kanë kontribuar si më poshtë:

Grupi “Ushqime, pije e duhan në njësi tregtare jo të specializuara dhe të specializuara” ka kontribuar me +1,3 pikë përqindje. Grupi “Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara” me +0,1 pikë përqindje dhe grupi “Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara” me -1,7 pikë përqindje.

**Fig. 2 Kontributi i degëve kryesore të Tregtisë me Pakicë në normën reale të mitjes (t1\_2020/t1\_2019)**



### Ndryshimi tremujor në indeksin e volumit të shitjeve në tregtinë me pakicë, përshtatur sezonalisht

Në tremujorin e parë 2020, volumi i shitjeve, përshtatur sezonalisht, në grupin “Tregti me pakicë, pa përfshirë këtu tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara”, ka pësuar rënie me 2,4 %, krahasuar me tremujorin paraardhës.

Në grupin “Ushqime, pije, duhan në njësi tregtare jo të specializuara dhe të specializuara”, volumi i shitjeve, përshtatur sezonalisht, është rritur me 0,5 %, krahasuar me tremujorin paraardhës.

Volumi i shitjeve, përshtatur sezonalisht, në tregtinë me pakicë, për grupin “Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara”, është ulur me 2,0 %, kundrejt tremujorit të mëparshëm.

Në grupin “Tregti me pakicë hidrokarbure në njësi tregtare të specializuara”, volumi i shitjeve, përshtatur sezonalisht, është ulur 8,7 %, kundrejt tremujorit të katërt 2019.

**Tab. 1 Ndryshimi vjetor i indeksit të shitjeve neto në tregtinë me pakicë dhe tregtinë me pakicë të Hidrokarbureve (përshtatur sezonalisht)**

NVE Rev.2	Aktiviteti Ekonomik	I.19 / I.18	II.19 / II.18	III.19 / III.18	IV.19 / IV.18	I.20 / I.19	%
47	Tregti me Pakicë	3,2	3,5	3,9	3,9	-0,4	
47 pa 473	Tregti me Pakicë (Pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara)	3,5	4,7	3,4	3,7	1,8	
4711;472	Ushqime, pijë e duhan në njësi tregtare të jo të specializuara dhe të specializuara	3,2	5,7	1,8	2,6	5,0	
4719; 474-478	Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara	3,8	4,0	4,6	4,4	-0,2	
473	Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara	2,3	0,5	5,0	4,8	-6,1	

**Tab. 2 Ndryshimi tremujor i indeksit të shitjeve neto në tregtinë me pakicë dhe tregtinë me pakicë të hidrokarbureve (përshtatur sezonalisht)**

NVE Rev.2	Aktiviteti Ekonomik	I.19 / IV.18	II.19 / I.19	III.19 / II.19	IV.19 / III.19	I.20 / IV.19	%
47	Tregti me Pakicë	-0,3	2,1	2,0	-0,1	-4,3	
47 pa 473	Tregti me Pakicë (Pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara)	-0,8	2,5	1,6	0,2	-2,4	
4711;472	Ushqime, pijë e duhan në njësi tregtare të jo të specializuara dhe të specializuara	-2,1	3,9	-0,1	0,6	0,5	
4719; 474-478	Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara	2,9	1,1	1,3	-0,9	-2,0	
473	Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara	0,8	1,4	5,0	-2,6	-8,7	

**Tab. 3 Ndryshimi vjetor i indeksit të shitjeve neto në tregtinë me pakicë dhe tregtinë me pakicë të hidrokarbureve, sipas muajve (përshtatur sezonalisht)**

NVE Rev.2	Aktiviteti Ekonomik	01-20 / 01-19	02-20 / 02-19	03-20 / 03-19	%
47	Tregti me Pakicë	14,7	8,6	-22,8	
47 pa 473	Tregti me Pakicë (Pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara)	15,0	9,6	-17,3	
4711;472	Ushqime, pijë e duhan në njësi tregtare të jo të specializuara dhe të specializuara	5,6	7,6	2,1	
4719; 474-478	Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara	21,0	10,9	-29,7	
473	Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara	14,2	6,1	-37,1	

**Tab. 4 Ndryshimi më i madhi i indeksit të shitjeve neto në tregtinë me pakicë dhe tregtinë me pakicë të hidrokarbureve, sipas muajve (përshtatur sezonalisht)**

NVE Rev.2	Aktiviteti Ekonomik	%		
		01 -20 / 12-19	02-20 / 01-20	03-20 / 02-20
47	Tregti me Pakicë	7,2	-3,5	-28,2
47 pa 473	Tregti me Pakicë (Pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara)	5,8	-1,6	-24,7
4711;47 2	Ushqime, pije e duhan në njësi tregtare të jo të specializuara dhe të specializuara	-1,8	2,1	-4,2
4719; 474-478	Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara	16,9	-5,8	-34,0
473	Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara	8,9	-7,7	-36,5

**Tab. 5 Indekset mëjore në vlerë dhe volum në tregtinë me pakicë (papërshtatur sezonalisht)**

2015=100									
NVE Rev.2 Grup 47									
Viti	2017		2018		2019		2020		
Muaji	Vlerë	Volum	Vlerë	Volum	Vlerë	Volum	Vlerë	Volum	
1	93,2	92,7	97,2	95,1	102,3	98,8	118,2	113,3	
2	93,3	92,6	96,6	94,0	100,1	96,3	109,4	104,6	
3	104,8	103,3	105,6	102,5	110,0	105,9	85,7	81,7	
4	100,5	99,6	104,6	102,0	109,0	104,9			
5	104,5	104,5	109,6	107,3	114,7	111,3			
6	107,2	107,9	112,1	109,6	117,1	113,8			
7	114,9	115,7	121,3	118,7	126,3	123,1			
8	120,9	121,3	130,7	127,5	137,7	134,0			
9	109,0	109,2	116,0	112,9	119,6	116,2			
10	114,7	114,6	116,6	113,0	119,5	116,2			
11	106,4	105,9	113,9	110,6	117,7	114,5			
12	127,8	126,3	136,4	132,3	143,6	139,0			

**Tab. 6 Indekset mujore në vlerë dhe volum në tregtinë me pakicë të hidrokarbureve (papërshtatur sezonalisht)**

2015=100

NVE		Grup 4730						
Viti	2017		2018		2019		2020	
Muaji	Vlerë	Volum	Vlerë	Volum	Vlerë	Volum	Vlerë	Volum
1	88,9	93,9	89,3	91,2	97,0	98,1	111,5	112,0
2	84,4	89,1	87,2	89,3	86,3	87,2	91,8	92,5
3	93,5	96,6	95,1	97,3	98,2	98,7	59,1	62,1
4	90,3	93,2	96,0	98,2	97,1	97,1		
5	92,9	96,6	103,8	104,4	102,5	102,6		
6	96,8	101,9	105,5	105,2	109,3	109,6		
7	106,7	112,3	117,1	116,5	120,7	121,2		
8	118,7	124,9	127,7	126,7	138,3	138,8		
9	93,1	97,9	110,1	109,1	109,5	110,0		
10	96,6	101,4	107,3	103,7	109,3	109,7		
11	93,3	95,8	102,1	98,6	101,2	101,6		
12	102,4	104,8	109,5	108,4	113,8	114,2		

# Metodologjia

## Informacion

Në tremujorin e parë (Janar – Mars) 2020, me marrjen e masave të veçanta për parandalimin e përhapjes së infekzionit të shkaktuar nga COVID-19, INSTAT ka ndërprerë intervistat direkte në ndërmarrje. Në Anketën Tremujore pranë Ndërmarrjeve të Tregtisë me Pakicë, për t'ju përgjigjur situatës së krijuar për vlerësimin e treguesve ekonomik, është përdorur metoda e kombinuar e burimeve administrative dhe intervista me telefon. Të dhënat janë objekt revizionimi.

Në vazhdim të përpjekjeve të përafrimit dhe standardizimit të statistikave të Tregtisë me Pakicë me statistikat evropiane, INSTAT publikon Indeksin e volumit në Tregtinë me Pakicë si më poshtë :

- Indekset në Tregtinë me pakicë dhe Tregtinë dhe riparimin e automjeteve duke filluar nga tremujori i parë 2019, do të llogariten me vit bazë 2015=100.
- Peshat janë llogaritur bazuar në rezultatet e Anketës Tremujore në Tregtinë me Pakicë e Tregtinë dhe Riparimin e Automjeteve, për vitin 2018, realizuar nga INSTAT. Shifra e afarizmit është vlerësuar në nivel produkti. Për kodifikimin e produkteve është përdorur Nomenklatura e Produkteve (NP).
- Grupet kryesore të detajimit janë në përputhje me grupet koresponduese në Indeksin e Çmimeve të Konsumit

## Informacion mbi vrojtimin

Qëllimi - Statistikat tremujore të Tregtisë me pakicë pranë ndërmarrjeve tregtare përshkruajnë ecurinë dhe zhvillimet më të fundit të treguesve ekonomik në njësitë e shitjes me pakicë dhe konsumit të popullatës në vend.

Baza ligjore të cilës i nënshtronhet metodologjia e prodhimi të treguesve të Tregtisë me Pakicë, është rregullorja e Këshillit Evropian numër 1165/98, 19 Maj 1998, e rishikuar, mbi Statistikat Afatshkurtra.

Fusha e mbulimit - Bazuar në aktivitetin kryesor janë përfshirë në vrojtim:

- ndërmarrjet e tregtisë me pakicë gruji 47-NVE Rev.2 (përjashto 47.79-4799)
- tregtia me pakicë e hidrokarbureve gruji 473-NVE Rev. 2

Grupet janë vlerësuar në bazë të përqindjes që secili produkt ose mall ka zenë në shifrën gjithsej të afarizmit të realizuar nga ndërmarrjet. Për kodifikimin e produkteve është përdorur Nomenklatura e Produkteve (NP).

Grupet kryesore të detajimit janë në përputhje me grupet përkuese në Indeksin e Çmimeve të Konsumit. Indekset krahasohen me periudhën bazë,  $2015=100$ .

Peshat – Struktura e peshave në Tregtinë me Pakicë:

Ushqime, pijë e duhan në njësi tregtare të jo të specializuara dhe të specializuara 29,6 %

Artikuj jo-ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara 42,5 %

Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara 27,9 %

Modeli - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku:

Kampioni për ndërrmarjet me 1 - 4 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërrmarjet me 5 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

Mbledhja e informacionit - Për këtë tremujor është përdorur burimi administrativ dhe metoda e kontaktit me telefon të ndërmarrjeve. Mbulimi me burim administrativ për këtë aktivitet është 77,6 %.

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi tremujor në përqindje, ndryshimi vjetor në përqindje me një vit referues bazë, aktualisht  $2015=100$ . Të dhënrat nuk paraqesin vlera absolute.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variabash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indeksin e çmimeve të konsumit për periudhat përkatëse sipas grupeve përkuese.

Ndryshimi vjetor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njejtë të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njejitit vit.

Rishikimi – Indekset mund të rishikohen për disa arsyet: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur, etj.

Përkufizim i treguesit kryesor - Shifra e afarizmit përfshin shitjet mujore gjithsej që ndërmarrja realizon gjatë muajit nga shitja e produkteve apo shërbimeve përashtuar Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH).

Përshtatja sezonale dhe kalendarike

Përshtatja sezonale dhe kalendarike në seritë mujore / tremujore të Tregtisë me pakicë u zbatua duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.2. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecifikimin X-13 në serinë kohore Tremujori I 2005 - Tremujori I 2020. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme. Në serinë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë

(multiplikative). Në metodën multiplikative ekziston një lidhje midis komponentit të trendit , komponentit sezonal dhe komponentit irregular, ku ky i fundit shpjegon ato pjesë të serisë kohore të cilat nuk mund të parashikohen dhe janë të pazakonshme. Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezionale dhe kalendarike në pasqyrimin e statistikave tremujore. Për përshtatjet sezionale të serive është përdorur qasja direkte. Për përshtatjen kalendarike është përdorur specifikimi i ditëve tregtare dhe kalendari kombëtar, duke marrë në konsideratë sifestat fikse dhe ato të lëvizshme.

Në përshtatjen sezionale janë analizuar edhe ngjarjet e vecanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.